Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 09-020/24-0066175/10, **dt.** 04.11.2026
Mitrovicë e Jugut

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Propozimit me email zyrtar të datës 04.11.2026 nga Drejtori i Drejtorisë së Pronës, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M
(Për Ndryshim-Plotësimin e Vendimit Nr. 01-020/04-0030706/26, të datës 28.05.2026)

1. **Ndryshohet paragrafi 2** i Vendimit Nr. 01-020/04-0030706/26, dt. 28.05.2026, dhe riformulohet si në vijim:

2. Detyrë e Komisionit të lartcekur është verifikimi dhe vlerësimi i gjendjes faktike në Zonën Ekonomike "Parku Industrial", në fshatin Frashër i Vogël, dhe në Parkun e Biznesit në Komunën e Mitrovicës së Jugut, përmes shqyrtimit dhe analizimit të kontratave përkatëse, dokumentacionit relevant, si dhe pretendimeve dhe arsyetimeve të paraqitura me shkrim nga palët kontraktuese, me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike dhe vlerësimit të përmbushjes ose mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontratat përkatëse.

3. Të gjitha pjesët tjera të Vendimit Nr. 01-020/04-0030706/26, dt. 28.05.2026, mbesin të pandryshuara.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PECI

Shtojcë:
Vendimi Nr. 01-020/04-0030706/26, dt. 28.05.2026;
Email i datës 04.11.2026, nga z. Jeton Zeneli – Drejtor i Drejtorisë së Pronës.

T'i dorëzohet:
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Zyrës për Informim
1x1 DP, DPU dhe DEZHTIE
1x1 Arkivit